



		MBIEMRI					QYTETI				
		Mustafa	Rakipi	Halimi	Bilalli	Veliu	Kumanova	Dibra	Shkupi	Struga	Tetova
EMRI	Jeton										
	Dan										
	Arif										
	Jon										
	Martir										
QYTETI	Struga						TABELA	Mbiemri	Qyteti		
	Kumanova						Jeton				
	Shkupi						Dan				
	Tetova						Arif				
	Dibra						Jon				
							Martir				

Në garat e matematikës, pesë vendet e para, nga gjithsej 300 konkurrues, u takuan nxënësve që vinin prej pesë qyteteve të ndryshme. Gjejini emrat, mbiemrat dhe qytetet e që të pesë nxënësve!

Të dhënat:

1. Këtë verë, në një kamp veror, Martiri, nxënësi nga Struga, u takua me nxënësin me mbiemrin Halimi.
2. Rakipi, i cili nuk e ka emrin Jeton dhe nxënësi nga Tetova, përveç matematikës, merren edhe me futboll.
3. Joni dhe Bilalli ishin në mesin e pesë të parëve edhe vitin e kaluar.
4. Halimi nuk është nga Dibra dhe hobi i tij është shahu.
5. Arifi fitoi numrin maksimal të pikëve në Shkup.
6. Pesë studentët janë: Joni, Jetoni, Dani, Mustafa, nxënësi nga Struga dhe ai nga Tetova.
7. Rakipi, i cili nuk e ka emrin Jon, tre vjet me radhë është fitues i garave.
8. Rakipi nuk është as nga Kumanova as nga Shkupi.
9. Mbiemri i Jonit nuk është Halimi.